

hapet konkursi për garën studimore të studentëve

PRISHTINË. Kosova Case Challenge apo Rasti Sfidues i Kosovës përfaqëson gjysmë finalen për Balkan Case Challenge, një garë vjetore e rastit studimor si dhe një ngjarje e rekrutimit për 100 studentë nga Evropa Juglindore. Rasti Sfidues i Kosovës që organizatës për ndihmë të Arsimit WUS - Austria synon hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja studentëve të

shkëlqyer të Arsimit të Lartë të Kosovës forcon lidhjet në mes të Edukimit të Lartë dhe punësimit. Përfunduesit do të garojnë në fushat e biznesit, gjyqit, teknologjisë dhe integriteteve evropiane. Kjo organizatë ka filluar pranimin e aplikacioneve të studentëve ndërsa konkursi do të jetë i hapur deri në mars. Udhëheqësit e WUS Austria kanë bërë të ditur të mërkurën

se vërehet një interesim i madh i studentëve për të marrë pjesë. Rastet studimore zhvillojnë aftësitë prezantuese, shkathësitë analitike, kreativitetin, të menduarit kritik dhe sistematik, kontribuojnë në rritjen e vetëdijes dhe kapaciteteve në zgjidhjen e problemeve si dhe zhvillon aftësi fleksibile në punë grupore dhe komunikim.

“Këto aftësi përfaqësojnë

kualifikime profesionale që janë standarde kur një punëdhënës e lexon një aplikacion punësimi”, kanë theksuar përfaqësuesit e WUS - Austria. Kjo organizatë i ofron mundësi kompanive, institucioneve, organizatave ndërkombëtare që të bëhen partnerë në mënyra të ndryshme. Kosova Case Challenge 2010 (Rasti Sfidues i Kosovës) do të mbahet gjatë datave 7,8 dhe 9 Maj. **AK**

|| ZËRI, || 28 JANAR 2010